

PROFESOR ROLAND PINGULI (1941-2022)

DHIMITËR HAXHIMIHALI

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Kimisë
Industriale, Seksioni i Inxhinierisë Kimike



Profesor **ROLAND PINGULI** rrjedh nga një familje qytetare, arsimdashëse. I ati i tij, Dhimitër Pinguli (1907-1984) ishte biri i një familjeje beratase. Ky pasi kreu Gjimnazin e shtetit në Shkodër (ishte ndër maturantët e parë të atij gjimnazi), ndoqi studimet universitare në Francë, në Fakultetin e farmacisë të Universitetit të Tuluzës, si dhe në Fakultetin e kimisë industriale në Universitetin e Marsejës.

Pas diplomimit ai u kthye në atdhe dhe ka punuar në sektorin farmaceutik, por më shumë në sektorin e kimisë industriale e në laboratorët kimikë e ushqimorë. Me natyrën studimore që e karakterizonte ai punoi dhe mbrojt

studimin për gradën kandidat i shkencave kimike.

Rolandi lindi në Vlorë më 31.10.1941; ishte fëmija i parë ndër katër djemtë në familje. Arsimin fillor e kreu në qytetin e Kuçovës, kurse atë të mesëm në Gjimnazin Qemal Stafa të Tiranës (1958). Po atë vit, sipas shembullit të të atit, u regjistrua në degën e kimisë industriale, që sapo ishte çelur në Fakultetin e shkencave të natyrës, të cilën e përfundoi më 1962. Me rezultatet e larta që arriti, ai u mbajt menjëherë në fakultet si asistent-pedagog dhe u ngarkua me zhvillimin e punëve laboratorike të teknologjisë kimike inorganike dhe organike. Atij i takon merita të ishte i pari që ngriti dhe udhëhoqi këta laboratorë, ndonëse i vetëm dhe në një kohë kur aparaturat e pajisjet laboratorike qenë të pakta. Punën për

pasurimin dhe përsosjen e laboratorëve, ngritjen e tyre në nivel më të lartë metodik e shkencor, ai do ta vazhdonte me pasion dhe në mënyrë krijuese, gjatë gjithë jetës së tij akademike.

Që nga viti 1968, Rolandi u ngarkua me zhvillimin e kursit teorik të lëndës teknologjia kimike inorganike¹ që deri atë kohë e mbante si profesor i jashtëm Ernest Bushati (1912-1993), një nga themeluesit e degës së kimisë industriale dhe pedagogu i parë i kësaj lënde që nga viti 1959. Kështu filloi një periudhë e re e punës mësimore edukative për të cilën duheshin përgatitur edhe tekstet mësimore përkatëse.

Përgatitja e teksteve të reja mësimore me autorë shqiptarë nuk qe punë e lehtë, pasi mungonte tërësisht një traditë e tillë, por me këmbëngulje e zell prof. Rolandi arriti të botojë në kohë e me cilësi, së pari tekstet e praktikave laboratorike të teknologjisë kimike inorganike e organike (1971) e më pas tekstet teorike të teknologjisë kimike inorganike (pjesa III, 1972 dhe pjesa IV, 1973), më pas edhe tekstin e njehsimeve etj. Me kohë këto tekste do të ripunoheshin e rishikoheshin shumë herë, deri në botimet e fundit (2009 e në vijim) që janë në përdorim edhe sot e kësaj dite. Prof. Roland Pinguli është gjithashtu autor i një vargu materialesh mësimore për nivelin pasuniversitar, si Bazat fiziko-kimike të teknologjisë së silikateve (leksione të shkruara, 1981), Proceset e pjekjes në qeramikë etj., si dhe i disa teksteve për nivelin shkollor parauniversitar.

Në vazhdimësi e shkallë-shkallë u rishikuan programet e lëndëve përkatëse dhe u hartuan plane mësimore të reja të degës së kimisë industriale, veçanërisht në dy periudha të rëndësishme: në kalimin nga sistemi 4-vjeçar në atë 5-vjeçar që nga vitit mësimor 1966/67, e sidomos në kalimin në sistemin e Bolonjës (baçelor+master) përkatësisht, gjatë viteve mësimore 2005/2006 dhe 2008/2009. Në të gjitha këto procese prof. Rolandi dha ndihmesën e tij të çmuar. Në rritjen e nivelit mësimor e shkencor, Rolandi përfitoi edhe nga kualifikimet e kryera jashtë shtetit, në Francë 1972 (6 muaj) dhe në Itali 1996 (2 muaj).

Kur në vitet 1975-78 ai u detyrua të shkojë “në qarkullim” në fabrikën e çimentos në Fushë Krujë, ku arriti edhe postin e kryeinxhinierit, katedra kishte nevojë të pazëvendësueshme për dijet e përvojën e tij, ndaj i mbajti lidhjet me të si mësimdhënës i jashtëm, por edhe në kërkimin shkencor.

¹ Lënda teknologjia kimike inorganike iu ngarkua njëkohësisht dy pedagogëve të rinj: Dh. Haxhimihali (pjesa I) dhe R. Pinguli (pjesa II). Për rreth 50 vjet ne e kemi mbajtur këtë lëndë dhe kemi bashkëpunuar krahas krahas (shën. i autorit).

Gjatë dekadash duke punuar me studentë në auditorë, laboratorë, në praktika mësimore në uzina e fabrika kimike, por edhe në aksione, stërvitje ushtarake, ekskursionet etj. u përgatitën e u përcollën breza të tërë studentësh, më se 2000, dhe besoj se është afër 100 numri i diplomantëve të udhëhequr nga prof. Rolandi. Këta ish-studentë gjenden tani jo vetëm në të gjitha qytetet e Shqipërisë, por edhe jashtë vendit, si ShBA, Kanada e deri në Izrael e Kinë dhe kujtojnë me respekt pedagogun e tyre të paharruar.

Në fushën e kërkimit shkencor prof. Rolandi krijoi një tematikë të qëndrueshme studimesh me interes në teknologjinë e silikateve, kryesisht në atë të çimentos. Ka realizuar studime të shumta për vlerësimin kimiko-teknologjik të lëndëve të para natyrore të vendit si lëndë e parë e industrisë silikate, si dhe në fushën e teknologjisë së çimentos. Edhe temën e disertacionit ai e ndërmori në këtë fushë: “Mbi mundësinë e prodhimit industrial të çimentove të markave të larta dhe përcaktimi i regjimit teknologjik të prodhimit”.

Ky studim me të cilin fitoi gradën kandidat i shkencave më 1982 (konvertuar në doktor shkencash më 1994) është punuar dhe zbatuar në Fabrikën e Çimentos Fushë Krujë. Si kryeinxhinier në fabrikën e çimentos në Fushë Krujë, prof. Rolandi ka merita për zgjidhjen e shumë problemeve shkencore e inxhinierike, në veçanti për prodhimin e çimentove të markave të larta etj. Kështu, ai ka kryer shumë studimeve teknologjike për zbatim, si “Mbi mundësinë e prodhimit të çimentos së markës M700 në rrugë industriale (1990), Përmirësimi i bilanceve materiale dhe termike të furrave vertikale të gëlqeres me thithje dhe fryrje artificiale, si dhe një varg projektesh teknologjike. Në këto fusha ai udhëhoqi me sukses 6 doktorantë për gradën shkencore “doktor i shkencave”. Për arritje të shënuara në fushën e kërkimit shkencor dhe mësimdhënie ai meritoi titullin shkencor “profesor” më 1994.

Jeta e prof. Roland Pinguli ka qenë e mbushur plot me punë të vazhdueshme, në veçanti me punë cilësore akademike në departamentin e kimisë industriale, punë që ka sjellë një kontribut të rëndësishëm për rritjen e nivelit të arsimit e kërkimi shkencor në fushën e kimisë industriale në FSHN. Kontributi i tij do të kujtohet kurdoherë me vlerësimin më të lartë. Por, profesori do të kujtohet gjithashtu edhe për natyrën njerëzore komunikuese me kolegët e studentët, për shpirtin e tij të qeshur e të gëzuar në jetë, për bujarinë e tij.